

SSH EN ISO 14001:2004



Është një standard ndërkombëtar që specifikon një proces për kontrollin dhe përmirësimin e performancës mjedisore për operatorët ekonomike private dhe sektorin publik.

Në Shqipëri operon Konsorciumi Italian ADA që ka si objektiv kryesor transferimin e kompetencave në fushën e Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë dhe Mjedisit, tek operatorët private dhe publike si dhe bashkëpunimin me sistemin e akreditimit kombëtar në këtë fushë. Synimi është që të rregullojë aktivitetet konsultative në fushën e Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor në përputhje me standardin ISO 14001:2004.



Standardi EN ISO 14001:2004 është i adoptuar si standard shqiptar S SH EN ISO 14001:2004 por ishte në tre versione gjuhësh të huaja, pra i papërkthyer. Që ky standard të merrte statusin e standardit shqiptar të përkthyer, duhej të organizohej puna në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS) nëpërmjet krijimit të një Nënkomiteti. Nisur nga kjo, DPS mbi bazën e një marrëveshjeje partneriteti të firmosur me Konsorciumin ADA, ngriti Nënkomitetin Teknik Nr.1 “Menaxhimi i mjedisit” i cili është pjesë përbërëse e Komitetit Teknik Nr. 1 “Sigurimi i cilësisë”. Detyra e tij ishte redaktimi i standardit të lartpërmendur, i cili ishte i përkthyer nga Konsorciumi ADA nga gjuha italiane në shqip. Anëtarët e zgjedhur në këtë Nënkomitet ishin specialistë të fushës përkatëse si dhe përfaqësues të Konsorciumit ADA. U punua për rreth dy muaj deri sa u arrit redaktimi i plotë i standardit dhe tani ndodhet në arshivën e DPS edhe në gjuhën shqipe.

Na kontaktoni:

Rruga “Mine Peza”, Nr.143/3,
1014 - Tiranë, Shqipëri
Kutia Postare 98
Tel: (04) 22 62 55; (04) 24 71 75
Fax: (04) 24 71 77
E-mail: info@dps.gov.al